

**ERIKETA KAMBO: "SHKOLLA SHQIPTARE NË VITET 1960-1970",
KRISTALINA-KH, Tiranë viti, 499 f.**

Në komunitetin e studiuesve dhe për publikun vendas e të huaj, prof. Kambo është e njohur si specialiste e historisë së arsimit shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore, tematikë të cilës ajo i ka kushtuar deri tani 3 monografi dhe një varg artikujsh shkencorë e kumtesash të botuar brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë.

Të shkruash për arsimin shqiptar në vitet '60-'70 pas një distance kohore pothuajse gjysëm shekulli, mendoj se është një kohë e mjaftueshme për të perceptuar drejt strategjinë e shkollës shqiptare në të gjitha nivelet dhe llojet e saj, për të dalluar kulmet, uljet e ngritjet në këta vite, si dhe për të vlerësuar me objektivitet e korrektesë shkencore çfarë u bë mirë, çfarë mund të bëhej edhe më mirë dhe çfarë nuk u arrit të bëhej. Përpjekjet serioze të autores Kambo për ta parë ecurinë e shkollës shqiptare nëpërmjet disa optikave dhe këndvështrimeve, janë të dukshme. Profesore Kambo ka arritur të na japë një tablo plot kontraste të procesit mësimor në vitet '60-'70, të masivizimit të arsimit shqip si në qytete ashtu dhe në fshatra, të shtimit të numrit të shkollave e të mësuesve deri te hapja e Universitetit Shtetëror të Tiranës, të karakterit shkencor të përmbajtjes së mësimin, ashtu siç e ngërthen të tërë këtë proces me ndërhyrjet e drejtpërdrejta e të tërthorta të politikës, duke na servitur një varg dokumentesh për vendimet e plenumëve të KQ PPSH, të Byrosë Politike të PPSH, të organizatave të rinisë e të një varg levash të tjera që formonin mekanizmin e fuqishëm të pushtetit politik ndaj arsimit.

Objekti që Prof. Eriketa Kambo trajton në monografinë e saj nuk është i lehtë. Nga gjithë gama e vështirësive, unë do të veçoj tre prej tyre:

Së pari, numri i stërmadh i dokumenteve zyrtare, ku e njëjta çështje trajtohet në disa struktura shtetërore dhe partiake, gjë që krijon rrezikun e rimarrjes së problemeve. Eriketa ka arritur t'i shmangët këtij rreziku.

Së dyti, duke punuar me dokumente zyrtare, ku shfaqet vetëm ana e shndritshme e arsimit në Shqipëri, sukseset dhe arritjet, lodhja bëhet e dyfishtë pasi autores i është dashur të lexojë njëkohësisht atë çka shkruhet e duket dhe atë çka fshihet midis rreshtave. Dhe kjo për një studiues është sa tërheqëse aq edhe një punë rraskapitëse.

Së treti, nxënësit dhe studentët që u arsimuan në ato vite, janë ende në jetë dhe tek një pjesë e madhe e tyre, krahas krenarisë për arsimimin e fituar, mbijeton dhe mentaliteti ideologjik e partiak i shoqërisë së asaj kohe, që i bën ata të mos e konsiderojnë të gjithë procesin në tërësinë e vet.

Në monografi, në pikëpamje metodologjike, kriteri kronologjik është i ndërthurur me atë problemor. Problemet e ndryshme me të cilët përballet arsimit shqiptar, si masivizimi, dokumentacioni mësimor, përmbajtja shkencore, orientimi politik, lidhja me prodhimin, kushtëzimi dhe përshtatja ndaj kushteve ekonomike shoqërore të vendit, përzgjedhja e studentëve me prioritet familjet e varfra punëtore dhe fshatare, tërheqja e vajzave në shkollë, përshtetimi i përgatitjes së mësuesve, marrëdhëniet mësues-nxënës dhe nismat revolucionare të këtyre të fundit të inicuar dhe kontrolluara gjithnjë nga Partia-shtet, të gjitha këto trajtohen kronologjikisht sipas niveleve përkatëse të shkollave. Kjo ndërthurje dhe materiali faktik, drejtpërdrejt nga realiteti dhe arkivat, e bëjnë monografinë plot lëndë, interesante dhe mbi të gjitha të qartë për të kuptuar në tërësi ecurinë e vërtetë të procesit mësimor. Dy reformat, “Riorganizimi i arsimit” dhe “Revolucionarizimi i shkollës”, janë dy shtyllat kryesore ku autorja e mbështet monografinë e saj. Rreth tyre trajtohen me hollësi legjislativi partiak dhe shtetëror për arsimin, përmbajtja e programeve të shkollës konform dokumentacionit përkatës, pritshmëritë, dukuritë dhe tendencat e zhvillimit të arsimit në të gjitha nivelet. Autorja ndjek vendim pas vendimi, hapa pas hapi të gjithë procesin arsimor të viteve '60, **i cili është një proces në kërkim të Boshtit ideologjik Mësim-Punë prodhuese-Kalitje fizike dhe ushtarake.** Metodologjia revolucionare që u ndoqën për t'ia nënshtuar shkollën këtij eksperimenti të huazuar nga përvoja kineze, i nxori jashtë përdorimit vetë jeta por edhe thyerja e marrëdhënieve politike me Kinën e largët.

Një vend të rëndësishëm në monografi Prof. Keti Kambo i jep arsimin të lartë, krijimit dhe ecurisë të procesit mësimor në USH Tiranës, të cilin ajo e quan “tempull” të elitës intelektuale, por ku dhe ideologjia e politika e PPSH do të ishin filli i kuq në programet për përgatitjen e kësaj elite. Autorja tërheq vëmendjen e lexuesit se në vitet '60, procesi mësimor në USHT ishte moduluar sipas formatit sovjetik, ndërsa kur filloi procesi i revolucionarizimit, filluan të depërtonin praktikën e Revolucionit Kulturor Kinez, siç ishte p.sh. lidhja e mësimin me prodhimin e stërvitjen ushtarake në kurriz të përgatitjes shkencore. Revolucionarizimi i shkollës në ato vite ishte pjesë e platformës së PPSH për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit, proces që Hoxha e ndërmoi jo vetëm nën shembullin kinez por edhe për të tërhequr vëmendjen nga Pranvera e Pragës, e vitit 1968, dhe nga lëvizjet e rinisë në Perëndim, që nuk kishin asgjë të përbashkët me komunizmin. Ai nxiti iniciativën dhe ia arriti të tërhiqte në të pedagogët, studentët e gjithë shoqërinë shqiptare. Pavarësisht vlerave dhe antivlerave që solli ky revolucion nga lart në shkollën shqiptare, autorja ka të drejtë kur pohon se arsimit të lartë kontribuoi në emancipimin e shoqërisë shqiptare.

Gjuha e përdorur në monografi është plot lëndë, e qartë dhe e rrjedhshme, gjë që e bën librin të lexohet me interes e kënaqësi.

Monografia e Prof. Kambo është fryt i një pune shumëvjeçare hulumtuese në arkiva e biblioteka, si dhe është mbështetur në arritjet më të mira të historiografisë shqiptare për situatën politike, ekonomike, kulturore në përgjithësi në Shqipëri, ashtu dhe për arsimin në veçanti. Gjithashtu nëpërmjet literaturës së huaj, autorja arrin të ketë dhe një vështrim krahasues me arsimin përkatës në vendet e Evropës Lindore, duke e konkretizuar në monografi me shifra e procese konkrete dhe të shoqëruara me shpjegimet e duhura. Hulumtimi i dokumenteve të shumta, i literaturës relevante dhe gjykimi i ftohtë i një historianeje me përvojë, ka bërë që prof. Eriketa Kambo të na japë një punim serioz dhe me vlera të mirëfillta shkencore për një nga segmentet më të dallueshëm dhe të debatueshëm të sistemit komunist në Shqipëri, siç ishte arsimi. Ai mbulon një boshllëk në historinë e arsimit shqip, por edhe të vetë shoqërisë shqiptare në vitet 60-70 dhe si i tillë, ai është i nevojshëm në bibliotekën e çdo studiuesi dhe jo vetëm.

Prof. dr. Ana LALAJ